



## **VENDIMI I DYTË MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË PANELIT**

**Data e miratimit: 16 shtator 2021**

**Nr. i lëndës: 2019-01**

**G.T.**

**kundër**

**EULEX-it**

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut (Paneli) i mbledhur më 16 shtator 2021, ku të pranishëm ishin anëtarët e paraqitur në vijim:

Znj. Anna AUTIO, kryesuese  
Z. Alexander FASSIHI, anëtar

Z. Ronald Hooghiemstra, zyrtar ligjor

Pas shqyrtimit të ankesës së lartpërmendur, e cila është dorëzuar në pajtim me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut dhe Rregullores së Punës së Panelit, e ndryshuar për herë të fundit më 11 dhjetor 2019.

Pas shqyrtimit përmes mjeteve elektronike, në përputhje me Rregulloren 13(3) të Rregullores së Punës së Panelit, u vendos si në vijim:

### **I. PROCEDURA PRANË PANELIT**

1. Kjo ankesa është regjistruar më 1 gusht 2019.
2. Ankuesja kërkoi që mos t'i zbulohet identiteti i saj. Duke marrë parasysh çështjen, në veçanti rrethanat e lëndës, Paneli është i bindur që kërkesa duhet të pranohet.
3. Me letrën e datës 5 gusht 2019, Paneli informoi Misionin për Sundimin e Ligjit të Bashkimit Evropian në Kosovë, EULEX-i Kosovë ("Misioni") se kjo lëndë ishte regjistruar në Panel.

4. Më 16 tetor 2019, Paneli kërkoi nga ankuesi që të sigurojë informacion shtesë në lidhje me ankesën.
  5. Më 29 tetor 2019, ankuesi paraqiti informacion shtesë.
  6. Më 26 nëntor 2019, Paneli i dërgoi Misionit një Deklaratë të Kërkesave dhe Pyetjeve, duke e ftuar që të parashtronte përgjigje dhe vërejtje me shkrim mbi ankesën jo më vonë se me datën 26 janar 2020.
  7. Paneli pranoi vërejtjet e shefit të Misionit më 18 shkurt 2020.
  8. Me një letër të datës 19 shkurt 2020, ankuesja u ftua t'u përgjigjej parashtresave të Misionit nëse ajo dëshironte ta bënte këtë.
  9. Më 12 mars 2020, ankuesja paraqiti vërejtjet e saj mbi parashtresat e Misionit.
  10. Më 4 qershor 2020, Paneli e shpalli ankesën të pranueshme në lidhje me pretendimet për shkelje të neneve 3 (ndalimi i torturës, trajtimin ose dënimit çnjerëzor ose poshtëruës) dhe 8 (e drejta për të respektuar jetën private dhe familjare, vendbanimin dhe korrespondencën) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut ("Konventa") (<https://hrrp.eu/alb/docs/Decisions/2020-06-04%20Admissibility%20Decision%202019-01%20signed-a.pdf>).
  11. Më 3 gusht 2020, Paneli pranoi parashtresat e ankuesit rreth meritave.
  12. Më 7 gusht 2020, Paneli i transmetoi këto Misionit për informacion.
  13. Më 1 tetor 2020, Paneli pranoi parashtresat e Misionit rreth meritave.
  14. Më 28 tetor 2020, Paneli i transmetoi këto tek ankuesja për informacion.
  15. Më 11 dhjetor 2020, Paneli lëshoi Vendimin dhe Gjetjet e tij në lidhje me meritat e lëndës ([2020-12-11 Vendimi dhe Gjetjet 2019-01-signed.pdf \(hrrp.eu\)](#)). Në atë vendim, Paneli gjeti që Misioni kishte shkelur të drejtën e ankuesit sipas nenit 3 të Konventës në një masë të kufizuar, siç përshkruhet në atë vendim. Paneli gjithashtu ftoi Misionin të marrë parasysh rekomandimet e mëposhtme:
    - i. Pranimi që sjellja e tij kontribuoi në shkeljen e të drejtave të ankuesit; dhe
    - ii. Të kontaktohen ankuesi dhe autoritetet vendore për të vërtetuar nevojën për siguri shtesë që del nga dëshmia e ankuesit në Serbi.
- Paneli gjithashtu i kërkoi ShM-së që t'ia shpërndajë vendimin e tij zyrtarëve përkatës të Misionit dhe autoriteteve jashtë tij.
16. Më 29 prill 2021, Paneli nxori vendimin e tij mbi zbatimin e rekomandimeve të Panelit. Në atë vendim, Paneli konstatoi se Misioni kishte zbatuar disa, por jo të gjitha rekomandimet e Panelit. Në veçanti, Paneli konstatoi se:
    - i. Misioni kishte dështuar të pranonte shkeljen e të drejtave të ankuesit nga Misioni, dhe e ftoi atë përsëri të pranonte një gjë të tillë, dhe,
    - ii. Misioni nuk kishte arritur të kontaktohej drejtpërdrejt me ankuesen në lidhje me përcaktimin e nevojës për siguri shtesë që buronte nga dëshmia e ankuesit në Serbi, dhe e ftoi Misionin ta bëjë këtë.

Paneli më tej vuri në dukje se përgjegjësia për të siguruar një mjet efektiv për shkeljet e të drejtave të kryera nga Misioni është dhe mbetet padyshim mbi vetë Misionin. Për aq sa Misioni nuk është në gjendje ose nuk dëshiron të miratojë plotësisht dhe tërësisht rekomandimet korigjuese të Panelit, Paneli vuri në dukje se mbetet përgjegjësia e Misionit për të gjetur mjete dhe metoda alternative të korigjimit që ofron ndonjë mjet efektiv për shkeljet që konstatohet se ka kryer.

Paneli gjithashtu i kërkoi shefit të Misionit që t'ia shpërndajë vendimin zyrtarëve përkatës të Misionit dhe autoriteteve jashtë tij.

17. Në vendimin e lartpërmendur, Paneli kërkoi nga Misioni që të raportojë përsëri mbi zbatimin e rekomandimit jo më vonë se me datën 20 gusht 2021.
18. Me anë të një letre të datës 219 gusht 2021, Misioni informoi Panelin për masat e ndërmarra në përgjigje të rekomandimeve të Panelit.
19. Në përputhje me rregulloren 45 e *tutje* të rregullores së tij të punës, Paneli do të shqyrtojë parashtresat e Misionit në lidhje me zbatimin e tij të rekomandimeve të Panelit.

## II. PËRBËRJA E PANELIT

20. Pas dorëheqjeve të fundit të dy anëtarëve të Panelit, Paneli do të ketë merr pjesë në këtë çështje me vetëm dy anëtarë në përputhje me rregullën 14 të rregullores së punës së Panelit.
21. Anëtari në largim i Panelit, i cili ishte anëtar i stafit të Misionit u zëvendësua nga z. Fassihi pas emërimit të tij nga Paneli. Për ta njohur plotësisht lëndën, z. Fassihi është familjarizuar me dosjen e lëndës dhe për këtë arsye është plotësisht në gjendje të marrë pjesë në diskutimet e këtij rasti.

## III. FAKTET

22. Faktet e lëndës, siç paraqiten nga parashtresat e palëve mund të përmbliidhen si më poshtë:
23. Ankuesja mori një thirrje nga një gjykatë në Kosovë për t'u paraqitur si dëshmitare në një seancë penale që po zhvillohej diku në vitin 2019 në një gjykatë në Republikën e Serbisë (në tekstin e mëtejme "Serbia"). Këto procedura penale kishin të bënin me krime të rënda që dyshohej se ishin kryer gjatë konfliktit në Kosovë në vitet 1998-99. Ankuesja më parë kishte dhënë deklaratatë të dëshmitares, përfshirë edhe në Mision, në lidhje me të njëjtat ngjarje.
24. Pak kohë pasi ankuesja kishte pranuar thirrjen dhe para datës së caktuar të seancës dëgjimore, Misioni kontaktoi ankuesen në lidhje me thirrjen dhe udhëtimin nga vendbanimi i saj në Kosovë për në Serbi për të dëshmuar në seancë.
25. Misioni më pas organizoi transportin dhe shoqëroi ankuesen në Serbi diku në vitin 2019.
26. Misioni gjithashtu përzgjedhi akomodim tjetër në Serbi për ankuesen kur u gjet se akomodimi i ofruar nga autoritetet serbe ishte i papërshtatshëm. Misioni kishte sjellë së bashku një mjek shqipfolës, pasi këto masa paraprake i kishte parë të nevojshme.

27. Sipas ankueses, ajo ishte kërcënuar dhe frikësuar përdherisa ishte në Serbi dhe më pas edhe në shtëpinë e familjes së saj në Kosovë, si rezultat i dëshmisë së saj në Serbi. Ankuesja vuan nga trauma si rezultat i këtij frikësimi.
28. Paneli thekson se kur bënte konstatimin e shkeljes së të drejtave të ankueses nga Misioni sipas nenit 3 të Konventës, Paneli vuri në dukje se kontributi i Misionit në dëmin e pësuar ankueses ishte i pjesëshëm, duke marrë parasysh ekzistencën paraprake të cenueshmërisë së ankueses, megjithatë serioze sipas mandatit të sundimit të ligjit të Misionit dhe besimit të dhënë nga ankuesja aty. Duke arritur në përfundimin se ky dëm plotësonte prapen e ashpërsisë së vuajtjeve të kërkuar sipas nenit 3, Paneli vuri në dukje konsideratat dhe rrethanat e mëposhtme:
  - i. Trauma dhe frika e viktimës ishte reale dhe e vërtetë;
  - ii. Cenueshmëria e ankueses si dëshmitare dhe viktimë e krimeve të rënda;
  - iii. Frika dhe shqetësimi - i njohur për Misionin - se ajo ndjeu se duhej të dëshmonte për ato krime dhe, për më tepër, ta bënte këtë në Serbi;
  - iv. Mungesa e qartësisë dhe transparencës në lidhje me shpërndarjen e përgjegjësisë për sigurinë dhe mirëqenien e ankueses përdherisa ishte në Serbi;
  - v. Dështimi i Misionit për të kryer një vlerësim të rrezikut ose/dhe për të siguruar që një i tillë ishte kryer nga autoritetet vendore;
  - vi. Dështimi i Misionit për të hetuar me zell a) pretendimet e kërcënimeve në Serbi dhe b) pretendimet e kërcënimeve në Kosovë;
  - vii. Dështimi i Misionit për t'u angazhuar plotësisht në lidhje me shqetësimet e ankueses dhe për ta lënë atë, që në vend të kësaj të kërkonte mjete juridike korrigjuese dhe mbrojtje vetë. (Shih 2019-01, *G.T. kundër EULEX-it*, 11 dhjetor 2020, paragrafët 85-86).

#### **IV. VLERSIMI PASUES NGA PANELI SIPAS RREGULLËS 45 E TUTJE**

29. Rekomandimi i parë i Panelit ishte që Misioni të pranonte që sjellja e tij kishte kontribuar në shkeljen e të drejtave të ankuesit.
30. Misioni u përgjigj se mendon se nuk ka shkelur të drejtat e ankueses dhe për këtë arsye nuk është i gatshëm të pranojë që ka ndodhur ndonjë shkelje e tillë.
31. Paneli shpreh keqardhjen që Misioni ka dështuar në zbatimin e rekomandimit të Panelit. Paneli i referohet konstatimit të tij të shkeljes së të drejtave të ankuesit nga Misioni sipas nenit 3 të Konventës. Qëllimi i vlerësimit vijues të Panelit është të vlerësojë zbatimin e rekomandimeve të Panelit nga Misioni, e jo të shqyrtojë përsëri nëse Misioni ka kryer apo jo shkelje. Paneli konstatoi në vendimin e tij të mëparshëm se Misioni ka bërë një shkelje.
32. Në bazë të asaj që u përmend më sipër, Misioni nuk ka ofruar argumente bindëse në lidhje me mos zbatimin e rekomandimit. Paneli vëren se megjithëse rekomandimet e tij nuk janë ligjërisht të detyrueshme, është thelbësore për besueshmërinë dhe legjitimitetin e Misionit - misioni i sundimit të ligjit - që ai duhet të demonstrojë me vendosmëri dhe besueshmëri angazhimin e tij për zbatimin efektiv të të drejtave të njeriut duke siguruar që veprimet janë në çdo kohë në përputhje me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut - dhe se është përgjegjës aty ku nuk i ka arritur këto standarde. Paneli ka theksuar në një numër vendimesh se njohja e shkeljes së të drejtave të njeriut mund të jetë një masë e rëndësishme dhe kuptimplote për ankuesin. Është gjithashtu një mënyrë që Misioni "të rregullojë", pjesërisht, për dështimin e tij për të respektuar dhe mbrojtur të drejtat e njeriut të ankuesit. Për fat të keq Misioni ka refuzuar ta bëjë këtë.

33. Rekomandimi i dytë i Panelit ishte që Misioni të kontaktonte ankuesin për të përcaktuar nevojën për siguri shtesë që rrjedh nga dëshmia e ankuesit në Serbi.
34. Misioni deklaroi se nuk ka mandat për të ndërmarrë këtë veprim. Misioni më tej thekson se "siguria e ankuesit është çështje që është nën autoritetin e institucioneve të Kosovës, e jo e EULEX-it Kosovë dhe Misioni e ka sjellë rastin në vëmendje të Policisë së Kosovës tashmë në shkurt të këtij viti, siç është komunikuar tashmë. Përveç kësaj dhe si një alternativë për rrjedhën e veprimit të propozuar nga Paneli, Misioni gjithashtu e solli rastin dhe vendimin e Panelit në vëmendjen e autoriteteve kompetente të prokurorisë të Kosovës për krime të luftës".
35. Lidhur me këtë parashtrësë nga Misioni, Paneli përsëri thekson se ishte Misioni që iu afrua në mënyrë proaktive ankueses në vitin 2019 në lidhje me udhëtimin e saj në Serbi për të dhënë dëshmi. Misioni më pas shoqëroi ankuesen në Serbi dhe sipas gjetjeve të Panelit, ishte përgjegjës për sigurinë e saj brenda kufijve të Kosovës. Misioni nuk ka dhënë ndonjë shpjegim bindës se pse, sipas mendimit të tij, ishte e lejueshme që Misioni nën mandatin e tij të kontaktonte në mënyrë proaktive ankuesen në disa raste gjatë vitit 2019, dhe pse nuk mund ta kontaktonte ankuesen më vonë në po të njëjtin mandat. Paneli nuk pajtohet me deklaratën se Misioni nuk ka mandat për të kontaktuar ankuesen dhe i vjen keq që Misioni tani nuk do ta kontaktoj ankuesen për të përcjellë shqetësimet e sigurisë që veprimi i tij ka kontribuar pjesërisht.
36. Në lidhje me parashtrësën e Misionit se ai e kishte sjellë rastin dhe vendimin e Panelit në vëmendjen e autoriteteve përkatëse si një veprim alternativ, Paneli konstaton si vijon. Së pari, përcjellja e vendimit tek autoritetet përkatëse ishte një rekomandim *i veçantë* i Panelit, në vendimin e tij të datës 29 prill 2021, e jo rekomandim *alternativ* për të kontaktuar drejtpërdrejt ankuesen. Së dyti, Misioni është përgjegjës ndaj obligimeve të veta sipas ligjit ndërkombëtar për të drejtat e njeriut, përfshirë ofrimin e mjeteve juridike në lidhje me shkeljet. Misioni nuk mund t'i delegojë përgjegjësitë e veta ndaj të drejtave të njeriut palëve të treta, siç janë autoritetet e Kosovës.
37. Paneli gjithashtu kërkoi që Misioni të shpërndajë vendimin e datës 29 prill 2021 tek zyrtarët përkatës të Misionit dhe autoritetet jashtë tij.
38. Misioni deklaroi se e ka sjellë vendimin e Panelit në vëmendjen e autoriteteve të prokurorisë së Kosovës. Paneli merr parasysh këtë hap të vlefshëm. Misioni nuk e trajton në mënyrë specifike pyetjen nëse e ka shpërndarë vendimin tek autoritetet e tjera përkatëse dhe brenda Misionit. Prandaj, Paneli thekson se Misioni e ka zbatuar pjesërisht këtë rekomandim.
39. Paneli shpreh keqardhjen që Misioni përsëri ka dështuar në zbatimin e plotë të rekomandimeve të Panelit, në veçanti që Misioni ka dështuar të kontaktojë ankuesen dhe se nuk ka dhënë ndonjë shpjegim bindës lidhur me dështimin e tij për ta bërë këtë.
40. Paneli shpreh keqardhje për mospërfilljen e vazhdueshme nga ana e Misionit e obligimeve të veta ndaj të drejtave të njeriut në këtë rast. Paneli nuk sheh arsye që të vazhdojë të përsërisë rekomandimet e tij aty ku Misioni tregon shpërfillje të obligimeve të tij ndaj të drejtave të njeriut duke dështuar në mënyrë të përsëritur në zbatimin e këtyre rekomandimeve. Në vend të kësaj, Paneli rithekson se përgjegjësia për të siguruar një zgjidhje efektive juridike për shkeljet e të drejtave të kryera nga Misioni është dhe mbetet padyshim mbi vetë Misionin dhe nuk mund t'i delegohet palëve të treta. Kjo përgjegjësi mbetet edhe atëherë kur Paneli vendos të mbyllë shqyrtimin e një rasti.

41. Prandaj, edhe aty ku Misioni nuk është në gjendje ose nuk dëshiron të zbatojë plotësisht rekomandimet e Panelit, si në rastin aktual, mbetet përgjegjësia e Misionit t'i ofrojë ankueses një mjet efektiv juridik për shkeljen që konstatohet se e ka kryer, përmes mjeteve korrigjuese alternative të rekomanduara ose adekuate.

**PËR KËTO ARSYE, PANELI NJËZËRI**

**DEKLARON** se Misioni nuk i ka zbatuar plotësisht rekomandimet e Panelit;

**SHPREH KEQARDHJE** për dështimin e Misionit që t'i zbatojë rekomandimet e Panelit;

**PËRSËRIT** se Misioni është përgjegjës për ofrimin e një mjeti efektiv për shkeljen e të drejtave të njeriut që ka kryer në rastin aktual, dhe se Misioni nuk mund t'i delegojë obligimet e veta ndaj të drejtave të njeriut palëve të treta;

**KËRKON NGA MISIONI** të shpërndajë këtë vendim zyrtarëve përkatës të Misionit dhe autoriteteve jashtë tij;

**VENDOS** të mbyllë shqyrtimin e kësaj lënde.

Për Panelin,

Anna AUTIO  
Kryesuese

Alexander FASSIHI  
Anëtar